Botues dhe autor: OJQ LINK
Adresa: Mbreti Petar 1, Mitrovica Veriore
Web-faqja: http/www.linkkosovo.org
Kontakti: office@linkkosovo.org

Avancimi i Politikave të Ndërmarrësisë Rinore Lokale përmes Qasjes së Pjesëmarrjes

Raport Hulumtimi

Ky publikim është shkruar si pjesë e projektit: "Avancimi i Politikave të Ndërmarrësisë Rinore Lokale përmes Qasjes së Pjesëmarrjes" implementuar nga LINK nga Mitrovica Veriore, 7 arte nga Mitrovica Jugore, financuar nga Fondi Katalitik i Shoqërisë Civile të Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës të zbatuar nga UN-Habitat, PAX dhe CBM. Opinionet, gjetjet dhe / ose përfundimet në këtë publikim janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.

Rezultatet më të rëndësishme:

47% të të anketuarve janë të papunë.

Niveli i papunësisë është shumë më i lart në mesin e të serbëve të Kosovës që janë anketuar (56.5%) se te shqiptarët e Kosovës që janë anketuar (40.4%).

33.9% të meshkujrve shqiptarë të anketuar deklaruan se janë të papunë ndërsa 47.3% të femrave shqiptare të anketuara e bënë të njejtën gjë. Nuk ka dallim të madh në këtë aspekt në mes të meshkujve dhe femrave të komunitetit serb që janë anketuar.

44.5% të të anketuarve planifikojnë të largohen nga Kosova. 9.6% më shumë serbë se shqiptarë duan të ikin nga Kosova.

Të anketuarit serbë ndihen më pak të sigurtë për të investuar në biznes në komunë. Nga 1 deri në 5, serbët e vlerësojnë sigurinë e investimit të tyre me 2.57. Në anën tjetër, të anketuarit shqiptarë e vlerësojnë sigurinë e investimit të tyre në Mitrovicën e Jugut me 2.80.

Një përqindje pak më e lartë e të anketuarve serbë (43.5%) se e të anketuarve shqiptarë (36.7%) deklaruan se kanë ide biznesi që planifikojnë ta realizojnë. Ngjashëm, një përqindje më e lartë e të anketuarve serbë (13.8%) ishin të pasuksesshëm në përpjekjet e tyre për ta realizuar idenë e biznesit, se fqinjtë e tyre shqiptarë (6.6%).

Një përqindje më e lartë e banorëve të Mitrovicës së Veriut 27.5%) se të banorëve të Mitrovicës së Jugut (13.7%) presin që autoritetet lokale t'i përmirësojnë kushtet për ndërmarrësi rinore.

Gati 60% të të anketuarve tonë deklaruan se nuk kanë marrë pjesë kurrë në diskutime publike të organizuara nga autoritetet komunale.

Konteksti:

Pyetësorët u mblodhën në periudhën 15 - 27 qershor në vende të ndryshme në Mitrovicë të Jugut dhe Veriut, dhe nga studiuesit u kërkua që t'i targetojnë të rinjtë të moshave 18 - 35. 400 pyetësorë u mblodhën në bazë të rëndomtë, nëpërmjet intervistave 1-në-1.

Dy komunat, Mitrovica e Veriut dhe e Jugut, dikur përfaqësonin një zonë të unifikuar administrative, një komunë të vetme, deri në vitin 1999.

Qyteti u nda në bazë joformale gjatë konfliktit në vitin 1999 kur ndryshimet e mëdha demografike dhe internimi i popullsisë nga jugu dhe veriu e bënë lumin Ibër kufi etnik.

Formalisht qyteti u nda në maj 2012, kur u formua zyra administrative për Mitrovicën e Veriut në sistemin e Kosovës. Në shkurt 2014, kjo zyrë u transformua në administratë komunale, dhe një Kryetar për të u zgjodh nëpërmjet zgjedhjeve lokale.

Dy komunat tani kryesisht janë të ndara përgjatë brigjeve të lumit Ibër, me përjashtim të një fshati që ende është territor i kontestuar ndërmjet dy administratave komunale. Megjithatë, pa marrë parasysh ndarjen etnike dhe gjeografike, qytetarët në dy anët e lumit ndikohen shumë nga degradimi i qytetit që dikur ishte kryeqytet industrial dhe kulturor, më i rëndësishëm edhe se Prishtina.

Kontrasti ndërmjet të kaluarës së pasur industriale që karakterizohej nga kompleksi i minierave Trepça e bizneseve të shërbimit që e mbështesnin gjigantin industrial, dhe ambientit të sigurisë jostabile pas konfliktit, veçanërisht në Mitrovicën e Veriut, është fokus kryesor i të gjitha diskutimeve që lidhen me ekonominë dhe këto dy komuna.

Gjithashtu, hulumtimet tregojnë se rinia në përgjithësi është në një pozitë shumë të vështirë, e kufizuar shumë nga kushtet jostabile të jetesës, që përkeqësohen nga tensionet etnike dhe politike, dhe kryesisht e izoluar nga të rinjtë e pjesëve tjera të Evropës.

Rinia ndihet e nënvlerësuar dhe e diskriminuar sa i përket ideve që mund të ofrojnë për të mirën e zhvillimit të komuniteteve të tyre.

Përshkrim i mostrës:

Dokumenti i mëposhtëm është pjesë e projektit që synon të rrisë veprimtarinë qytetare në ndikimin e prioriteteve, planifikimit dhe vendimmarrjes së qeverisjes lokale, duke prezantuar qasjen pjesëmarrëse në zhvillimin e strategjive lokale të ndërmarrësisë për të rinjtë në komunat e Mitrovicës Veriore dhe Jugore.

Hulumtimi i opinionit publik mbi ndërmarrësinë rinore u zhvillua në mënyrë që të mbështeste procesin e zhvillimit të strategjive komunale për ndërmarrësinë rinore të komunave të Mitrovicës Veriore dhe Jugore.

Përveç kësaj, qëllimi i një pjese të pyetjeve që kanë të bëjnë me nivelin e pjesëmarrjes aktual të të rinjve në këto dy komuna në nismat zhvillimit të politikave komunale është për të ndihmuar në krijimin e treguesve për matjen e progresit të ardhshëm apo regres të aktiviteteve të shënjestruara në këtë fushë të veçantë e angazhimit social me institucionet lokale.

Vetë hulumtimi është kryesisht sasior, por janë përfshirë gjithashtu katër intervista, dy tryeza të rrumbullakëta dhe dy fokus grupe. Një total prej 37 njerëzve u përfshinë në pjesën kualitative të hulumtimit, katër janë intervistuar, gjashtë persona janë përfshirë në tryezën e rrumbullakët në pjesën veriore të Mitrovicës, ndërsa tetë persona kanë marrë pjesë në fokus grup në Mitrovicën e Veriut, nga ana tjetër, janë përfshirë shtatë persona në fokus grupin në Mitrovicën e Jugut, ndërsa dymbëdhjetë vetë morën pjesë në tryezën e rrumbullakët në të njëjtën komunë.

Në pjesën kuantitative të hulumtimit ka pasur gjithsej 400 të anketuar nga komunat e Mitrovicës së Jugut dhe Veriut, një numër disi më i madh i të anketuarve ishin nga Mitrovica e Jugut (230), e cila gjithashtu ka pothuajse tre herë më shumë popullsi se Mitrovica e Veriut (170) . Duke pasur parasysh fokusi i projektit për të rinjtë, vetëm të anketuarit në mes 18 dhe 35 vjeç u morën në pyetje, dhe mosha mesatare e të anketuarve ishte 23.65.



Të anketuarit ishin të ndarë në mënyrë të barabartë sipas gjinisë, ku 198 të anketuar ishin meshkuj, 197 femra, dhe 5 refuzuan të përgjigjen.



Gati 60% të të anketuarve ishin shqiptarë të Kosovës, 1/3 ishin serbë të Kosovës dhe pak më shumë se 5% ishin boshnjakë.

Gjysma e të anketuarve kanë diploma baqellors dhe grupi i dytë më i madh i të anketuarve kanë kryer shkollën e mesme.



Gati gjysma e të anketuarve deklaruan se janë të papunë, ndërsa një e treta janë të punësuar. Papunësia është pak më e madhe në mesin e komunitetit të serbëve të Kosovës, në të cilin ka më pak punëtorë sezonalë dhe më pak të rinj të punësuar në orar të plotë. Ka dallime ndërmjet nivelit të arsimimit të të anketuarve. Tabela në vijim i tregon këto dallime:

	Shkollë fillore	Shkollë e mesme	Shkollë profesionale	Diplomë baqellors	Diplomë masters	Doktor-aturë	Total
Serbë	0%	28.1%	9.4%	38.1%	20.1%	4.3%	100%
Shqiptarë	0%	18.6%	13.9%	57.6%	9.5%	0.4	100%

Dallimet janë të mëdha, por kjo lidhet me moshën e të anketuarve, për shkak se në mesin e shqiptarëve të Kosovës të anketuarit kryesisht ishin të moshave 19-24, ndërsa serbët e Kosovës që u anketuan ishin të moshave 24-28.



The folloëing table shoës disaggregation of the employment rate by ethnicity.

	Të punësuar	Të papunë	Punëtorë sezonal	Total
Serbë	31.9%	56.5%	11.6%	100%
Shqiptarë	38.3%	40.4%	21.3%	100%

Edhe statusi i punësimit dallon sa i përket grupeve gjinore, ku 51.5% të të anketuarve femra deklaruan se janë të papunë, ndërsa meshkuj të papunë ishin 42.6%. Në komunitetin serb nuk ka dallime sa i përket statusin të punësimit të dy gjinive (56.7% të meshkujve të anketuar serbë janë të papunë dhe 56.3% të femrave të anketuara serbe janë të papunë), megjithatë, dallimi është më i madh në komunitetin shqiptar, ku 33.9% të meshkujve të anketuar shqiptarë deklaruan se janë të papunë, ndërsa 47.3% të femrave të anketuara shqiptare e dhanë këtë përgjigje.

Gjatë pjesës kualitative të studimit, nga të anketuarit u kërkua të ofrojnë interpretime më të afërta për dallimet në këto rezultate. Të anketuarit nga Mitrovica e Veriut deklaruan se dallimet mund të jenë për shkak se situata është më e qartë në Jug, pasi që aty nuk kanë sistem të dyfishtë të qeverisjes. Tjerët pretenduan se Mitrovica e Veriut, duke qenë shumë më e vogël, ofron më pak mundësi. Por të anketuarit në përgjithësi u pajtuan se tregu i punës në Kosovë është më i qasshëm për shqiptarët e Kosovës për shkak se kanë më shumë liri të lëvizjes.

Të anketuarit nga Mitrovica e Jugut kryesisht e shprehën mosbesimin e tyre për rezultatet, duke pretenduar se papunësia me siguri është më e madhe në Mitrovicë të Jugut. Një nga të anketuarit pretendoi se fakti që qyteti është i ndarë ndikon në nivelin e papunësisë.

Sipas të dhënave zyrtare të Zyrës për Punësim në Mitrovicën e Jugut, janë 6000 njerëz në këtë komunë të cilët kërkojnë vende pune nëpërmjet kësaj zyre. Megjithatë, Drejtori i Zyrës, Besmir Salihu, deklaroi se numri nuk pasqyron situatën reale, për shkak se jo të gjithë personat e papunë i përdorin shërbimet e Zyrës për Punësim. Ai shtoi se në 2017, kjo zyrë i kishte 40 përfitues për çdo post që ishte në dispozicion.

Rezultatet e hulumtimit:

Më shumë se 40% të personave që i anketuam deklarojnë se planifikojën të largohen nga Kosova. Sa i përket grupeve etnike, një përqindje më e lartë e serbëve të Kosovës planifikojnë të largohen nga Kosova. Ngjashëm, përqindja e meshkujve të anketuar që duan të largohen nga Kosova (50.8%) është më e lartë se përqindja e femrave të anketuara që e favorizojnë këtë ide (38.3%).



Gjatë pjesës kualitative të studimit, i pyetëm pjesëmarrësitë për pozitën e të rinjve në komunitetet përkatëse të tyre.

Sa i përket komunitetit në Mitrovicën e Jugut, përgjigjet e tyre mund të përmblidhen si vijon: rinia është aktive, e gatshme për punë vullnetare dhe për t'u angazhuar, por ata dekurajohen nga mungesa e vlerësimit apo edhe vëmendjes nga ana e sistemit, veçanërisht në procesin e vendimmarrjes. Një nga pjesëmarrësit gjithashtu ceku se numri i Organizatave të Shoqërisë Civile që merren me të rinj është reduktuar në vitet e fundit. Kushtet e padrejta të punës ishin gjithashtu çështje e shqetësimit për dy nga pjesëmarrësit, të cilët deklaruan se përqindja e vogël e të rinjve që janë të punësuar nuk kompensohen ose kërkohet prej tyre të punojnë pas orarit pa kompensim.

Si kontrast, rinia e Mitrovicës së Veriut e fajëson kryesisht vetën për situatën në të cilën është, duke u vetëpërshkruar si joaktivë apo të painteresuar dhe pa perspektivë. Përqindja e vogël e të rinjve që janë të punësuar janë kryesisht studentë të cilën nuk janë nga Mitrovica dhe duhet të punojnë për mbijetesë gjatë studimeve.

Grafiku në vijim tregon ndarjen e përgjigjeve sipas etnisë.



Një e treta e të anketuarve thonë se sektori publik është zgjedhja e parë e tyre sa i përket punësimit, ndërsa vetëm 11.2% e preferojnë punën në sektorin privat.



Pa marrë parasysh cilin sektor e zgjodhën, shumica dërrmuese e të anketuarve që kanë përvojë pune e kanë fituar këtë përvojë në sektorin privat. Burrat kanë më hsumë përvojë pune në sektorin privat (79.7%), por gjysma e femrave të anketuara e deklaruan të njejtën gjë (60.7%).



Nga të anketuarit kërkuam që ta ofrojnë perceptimin e tyre për atë se sa është i sigurt investimi në një biznes në komunën e tyre. Niveli i sigurisë u shpreh në një shkallë nga 1 (nuk ka siguri) deri në 5 (krejtësisht e sigurt). Përderisa 3 ishte përgjigja më e shpeshtë, përgjigja mesatare e të gjithë të anketuarve ishte 2.73. Të anketuarit serbë mendojnë se investimet e tyre janë më pak të sigurta (2.57) se të anketuarit shqiptarë (2.80). Gjithashtu, burrat ndihem më pak të sigurt për të investuar në komunat e tyre (2.61) se sa gratë (2.83).



Të anketuarit i pyetëm se cilët ishin faktorët kryesor të rrezikut sa i përket ndërmarrësisë rinore në komunat e tyre dhe situata jostabile politike u theksua si faktori më i rrezikshëm. Të anketuarit kishin mundësi të zgjedhin nga disa faktorë të rrezikut.



Gati gjysma e të anketuarve nuk kanë ide biznesore që planifikojnë ta zhvillojnë në tri vitet e ardhshme. Një përqindje më e lartë e të anketuarve serbë (43.5%) se të anketuarit shqiptarë (36.7%) deklaruan se kanë ide biznesi që planifikojnë ta realizojnë. Ngjashëm, një përqindje më e lartë e të anketuarve serbë (13.8%) nuk kishin sukses në realizimin e ideve biznesore se fqinjtë e tyre shqiptarë (6.6%). Dallimet në përgjigje ndërmjet gjinive nuk janë të mëdha.



Dhe përderisa situata politike është ajo që të anketuarit e panë si faktori më i madh i rrezikut për ndërmarrësi rinore në komunat e tyre në përgjithësi, situata është më ndryshe në plane individuale. Mungesa e kapitalit, krimi dhe situata politike janë probleme që rinia i sheh si shkaktarë të efekteve negative në aftësitë e tyre për ta nisur dhe rritur një biznes.



Dhe përderisa këto janë pengesat individuale, perceptimi i kolektivit në komunitet është tepër negativ. Për shembull, kur u kërkua prej tyre ta përshkruajnë rininë me një fjalë, të rinjtë nga Mitrovica e Veriut të cilët morrën pjesë në një fokus grup i përdorën përshkrimet në vijim: të varur, njerëz përtacë, të prapambetur, vetjakë, apatikë, presin të ardhme më të mirë.

Ndonëse pak më optimistë, reagimet e komunitetit shqiptarë rezonuan në mënyrë të ngjashme: pasiv prej 2015-ës, të dëshpëruar, të dëshpëruar për shkak të varësisë së tyre, pa motiv, të nënvlerësuar, të dëshpëruar për shkak të politikës aktuale, më optimistë.

E befasishme është që afro një e treta e të anketuarve kanë deklaruar se pikëpamjet dhe qëndrimet ndaj bizneseve private të njerëzve në shoqërinë e tyre janë negative. Tek të anketuarit shqiptarë (34.1%) kjo përqindje është më e lartë se tek të anketuarit serbë (24.5%).



Ngjashëm, gati një e treta e të anketuarve tonë nuk kanë ndërmarrësë të suksesshëm si modelë në familjen apo shoqërinë e tyre. Kur u krahasuan e etninë e të anketuarve, rezultatet treguan se përqindja e të anketuarve që kanë shembuj pozitivë të ndërmarrësve të suksesshëm në shoqërinë e tyre është pak më e lartë tek të anketuarit serbë (62.6%) se tek të anketuarit shqiptarë (48.3%).



Të anketuarit e pjesës kualitative të studimit raportojnë se Mitrovica e Veriut nuk është ambient i favorshëm për investime personale, për shkak se situata politike dhe e sigurisë mund të shkojë mbrapsht për disa ditë dhe të ketë pasoja serioze për bizneset private. Të rinjtë janë kreativë por nuk kanë motiv për ta investuar kohën, kreativitetin dhe kapitalin e tyre në një ambient të tillë. Dy nga të anketuarit pretendojnë se të rinjtë në Mitrovicën e Veriut kanë frymë të dobët ndërmarrëse, jo për shkak të ambientit, por për shkak të përtacisë së tyre.

Përsëri, hulumtimet kualitative treguan një kontrast të madh ndërmjet Mitrovicës së Veriut dhe Jugut, ku vetëm një i anketuar pretendoi se të rinjtë nuk janë të motibuar, ndërsa pjesa tjetër e grupit pretenduan se rinia janë tepër të motivuar por shpeshherë u mungojnë idetë e shumëllojshme apo mbështetja institucionale për t'i zhvilluar biznesete tyre.

Megjithatë, në rrethin e gjërë të të anketuarve tonë, modelët nuk mungojnë, pasi që shumica dërrmuese e të anketuarve tonë deklaruan se e njohin të paktën një ndërmarrës të ri të suksesshëm.



Më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se problemet e ndërmarrësisë rinore duhet të trajtohen në nivel lokal dhe qendror të qeverisjes. Më shumë të anketuarë nga Mitrovica e Veriut (27.5%) se nga Mitrovica e Jugut (13.7%) mendojnë se ndryshimet e politikave duhet të ndodhin në nivel lokal.



Ndarja e përgjigjeve sipas komunave:

	Niveli qendror	Niveli lokal	Niveli qendror dhe lokal	Nuk e di
Mitrovica e Jugut	9.7%	13.7%	50.2%	26.4%
Mitrovica e Veriut	7.8%	27.5%	55.7%	9%

Gati 60% e të anketuarve tonë deklaruan se asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në diskutime publike të organizuara nga autoritetet komunale. Pjesëmarrja e qytetarëve është pak më e lartë në komunën e Mitrovicës së Jugut, ku 46.5% të të anketuarve kanë marrë pjesë në diskutime publike të organizuara nga autoritetet, ndërsa në Mitrovicën e Veriut, 33.7% të të anketuarve e kishin këtë mundësi.

Në pjesën kualitative të hulumtimit, të anketuarit serbë shpjeguan dallimin ndërmjet dy komunave duke theksuar mungesën e besimit në autoritete komunale si dhe ndjesinë e pafrytshmërsië. Sipas tyre, qytetarët mendojnë se nuk do të vinin shumë ndryshime me pjesëmarrjen e tyre dhe diskutimet që organizohen vetëm për t'i përmbushur normat ligjore.

Të anketuarit nga Mitrovica e Jugut thanë se në përvojat e tyre, pjesëmarrja rinore është shumë më e lartë në diskutimet e organizuara nga Organizatat e Shoqërisë Civile, dhe se të rinjtë që marrin pjesë në diksutime komunale janë "vetëm disa", dhe nuk janë aty realisht për të realizuar ndryshime. Disa nga pjesëmarrësit e shohin një rol më të madh të institucioneve arsimore për ta përhapur informata për diskutime publike dhe vlerën e tyre për komunitetin.

Kërkuam gjithashtu nga të anketuarit që morrën pjesë në diskutime publike të organizuara nga autoritetet komunale që ta vlerësojnë atë se sa u respektuan nga autoritete komunale opinionet e dhëna nga qytetarët gjatë këtyre diskutimeve. Respektimi i kontrivuteve të qytetarëve u vlerësua me notë mesatare 2.71.



Një nga rezultatet më inkurajuese që tregojnë se niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve mund të shtohet në të ardhmën lidhet me faktin se 62.1% të të anketuarve që nuk kanë marrë kurrë pjesë në diskutime publike të autoriteteve komunale thanë se do të merrnin pjesë në një diskutim të tillë.



Qytetarët e Mitrovicës së Jugut që nuk kanë marrë kurrë pjesë në diskutime publike (67.8%) janë më të gatshëm për ta bërë këtë në të ardhmën se qytetarët e Mitrovicës së Veriut (55.9%).



Më shumë se 70% të të anketuarve shprehën interesim për të qenë pjesë e grupit punues për zhvillimin e strategjisë komunale për ndërmarrësi rinore.



Sa i përket pyetjeve në lidhje me pjesëmarrjen apo gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutime publike apo procese të vendimmarrjes,

nuk ka dallime ndërmjet gjinive në përgjigje.

Në përgjithësi, transparenca e komunave perceptohet si e dobët nga të anketuarit tonë. Nga 1 deri në 5, nota mesatare e dhënë nga të anketuarit është 2.39.



Në përpjekje për t'i gjetur ato që qytetarët i perceptojnë si mangësitë kryesore në marrëdhëniet publiek të autoriteteve të komunave përkatëse të tyre, ne i pyetëm se çfarë do të ndryshonin ata në mënyrën se si komunat e zhvillojnë komunikimin me publikun. Gati gjysma e të anketuarve mendojnë se puna e Zyrtarëve të Informimit Publik duhet të jetë më e dukshme.



Të anketuarit kryesisht e shohin rolin e komunës në mbështetje të ndërmarrësisë rinore si siguruese e kapitalit fillestar për ide të reja biznesore.



Olivera Pacariz nga administrata komunale e Mitrovicës së Veriut tha se nuk ka politika të zhvilluara për ndërmarrësi rinore dhe se Zyra për Arsim e ka caktuar një buxhet vjetor që është reduktuar gjatë viteve dhe sipas të cilit i planifikon aktivitetet. Ajo shtoi se Zyra e saj mundohet t'i adresojë nevojat e të rinjve nëpërmjet debateve publike dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, por se në përgjithësi të rinjtë janë pasivë.

Pacariz e sheh potencialin kryesor për zhvillimin e ndërmarrësisë rinore në sektorin e Teknologjisë Informative. Ajo gjithashtu shtoi se verifikimi i diplomave është problem që po kontribuon në nivelin e lartë të papunësisë në Mitrovicën e Veriut.

Zyra për Arsim e Komunës së Mitrovicës së Veriut i identifikoi problemet kryesore për të rinjtë: alkoholizmi, varësia, papunësia dhe qasja e dobët në informim.

Përveç që folën për rolin e komunës, nga të anketuarit u kërkua edhe ta shpjegojnë atë se si e shohin rolin e shoqërisë civile në

promovimin e ndërmarrësisë rinore. Më shumë se gjysma mendojnë se roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë aspekt është i parëndësishëm.

Nga të anketuarit u kërkua gjithashtu ta masin rëndësinë e investimeve në zona të posaçme të ekonomisë apo burime të caktuara, dhe në përgjithësi, ata mendojnë se ka nevojë për investime në sektorin ekonomik.

Në një intervistë me një ndërmarrës të ri nga Mitrovica e Veriut u vlerësua si pozitiv roli i shoqërisë civile në mbështetjen e ndërmarrësisë rinore. Ndonëse ai vet nuk ka kërkuar ndihmë për ta nisur biznesin, ai tha se do të kërkojë ndihmën e sektorit të shoqërisë civile për ta zgjeruar biznesin e tij. Ai tha se niveli i papunësisë duhet të shihet si mundësi për vetëpunësim. Ai vet u bë ndërmarrës pasi e humbi punën. Për më tepër deklaroi se kualiteti i dobët i shërbimeve ofron mundësi të barabartë për të gjithë që janë të gatshëm për të investuar në shërbime të kualitetit më të lartë.



Shumica e të anketuarve nga Mitrovica e Jugut që ishin në grupin e fokusit deklaruan se nuk dinë se çka janë prioritetet e investimit dhe pretenduan se komuna nuk ka strategji në lidhje me ndërmarrësinë rinore. Një nga të anketuarit rekomandoi që komuna ta krijojë një ambient që e mbështetë dhe shfrytëzon kreativitetin e të rinjve.

Të anketuarit nga Mitrovica e Veriut ishin të paqartë, por ofruan disa rekomandime konkrete, si investimi në institucione që merren me rini dhe kulturë, ose investimi në arsim joformal. Ata i analizuan donacionet që janë dhënë gjatë viteve për bizneset e reja dhe paralajmëruan se programet e tilla në të ardhmën duhet të kontrollohen më mirë.

Rajoni i Mitrovicës, veçanërisht komunat veriore të tij, është ndihmuar shumë nga ndërkombëtarët në vitet e fundit. Megjithatë, debatet për ndikimin e këtyre investimeve ende janë duke vazhduar. Shumica dërrmuese e të anketuarve tonë nuk mendojnë se donacionet e shpenzuara për mbështetje të ndërmarrësisë janë shpërndarë si duhet.

Nga të anketuarit që ofruan shpjegime për atë se pse mendojnë se ndihma e donatorëve ishte e pasuksesshme, shumica (62.8%) e citojnë korrupsionin dhe 20% e citojnë ndarjen e gabuar.

Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë moderne, nga të anketuarit u kërkua ta vlerësojnë disponueshmërinë e tregut online. Përkundër pritjeve stereotipike, nuk ka gati fare dallime në përgjigjet ndërmjet grave dhe burrave për këtë pyetje. Sa i përket burrave, përqindja e të anketuarve që nuk janë të interesuar në teknologji informative është 32.5%, ndërsa 31.1% të grave e ndajnë këtë opinion. Megjithatë, përqindja e grave që mendojnë se nuk ka programe të mjaftueshme që ofrojnë arsimim për teknologji informative (36.8%) është më e lartë se tek meshkujt e anketuar (23.6%).



Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk dinë se a ka kompani të teknologjisë informative në qytetin e tyre.